

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Katër elektrikistë të vdekur në pak muaj, kush mban përgjegjësi për sigurinë në terren?
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/12/kater-elektriciste-te-vdekur-ne-pak-muaj-kush-mban-pergje-gjesi-per-sigurine-ne-teren/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	12 shtator 2026, 12:37:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 12:36:05 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f6b7d9a273c66b5187701c548c8deb30256b6a9cf737b42c1d65fc6ad96fb988
TEKSTI	cf768af0aa7f214f0b191d97b8ef5394ae97c6c2005e705f485445edf15b8398
PAMJA	79222caa7c1519d7b1991d4fbb83f2189ff89b5f9db095d5329dc798b53164b1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f8b878bb091086925ca95aff0731e87a01dca3ba8390c029d33caf8a91695823
E MËPARSHMJA	ff0f30610d81159f190da958316cae157abaf85fa13b2f65974b399851c7c043
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f8b878bb091086925ca95aff0731e87a01dca3ba8390c029d33caf8a91695823>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [KRYESORE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [OP-ED](#)
- [VETTING](#)
- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKE](#)
- [SPORT](#)
 - [Botëroni 2026](#)
- [TE TJERA](#)
 - [PRIVACY POLICY](#)
 - [KONTAKT](#)
 - [EKONOMI](#)
 - [SHENDETI](#)
 - [SHOW BIZ](#)
 - [KULTURE](#)
 - [POLITIKE](#)
 - [KRONIKE](#)
 - [TEKNOLOGJI](#)
 - [VIDEOT KRYESORE TE DITES](#)
 - [VIDEO](#)
 - [BOLD BLOG](#)
 - [FOTOGRAFI](#)
 - [HOROSKOPI](#)
 - [NDRYSHE](#)
 - [RAJONI](#)
 - [BOTA](#)
 - [SOCIALE](#)
- [ZGJEDHJE 2025](#)

- [KRYESORE](#)

•
[Fillimi](#) [AKTUALITET](#)

Katër elektrikistë të vdekur në pak muaj, kush mban përgjegjësi për sigurinë në terren?

14:36 : 12/09/2026
në [AKTUALITET](#), [KRONIKE](#)

- 
- - [Botëroni 2026](#)
 - - [PRIVACY POLICY](#)
 - [KONTAKT](#)
 - [EKONOMI](#)
 - [SHENDETI](#)
 - [SHOW BIZ](#)
 - [KULTURE](#)
 - [POLITIKE](#)
 - [KRONIKE](#)
 - [TEKNOLOGJI](#)
 - [VIDEOT KRYESORE TE DITES](#)
 - [VIDEO](#)
 - [BOLD BLOG](#)
 - [FOTOGRAFI](#)
 - [HOROSKOPI](#)
 - [NDRYSHE](#)

- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [SOCIALE](#)

•

Një tjetër rast ku një elektrikist humb jetë gjatë punës është regjistruar në vendin tonë.

Ngjarja ka ndodhur sot në zonën e Belshit, ku elektrikisti i OSHEE-së, **Klajd Zekthi**, 32 vjeç ka humbur jetën teksa ndodhej në terren pas stuhisë që përfshiu zonën.

Raportohet se pas motit të keq dhe dëmtimeve të shkaktuara në rrjetin elektrik, ekipet e OSHEE-së kanë dalë në terren për të ndërhyrë dhe rikthyer furnizimin me energji elektrike.

Gjatë ndërhyrjes teknike 32-vjeçari dyshohet se ka rënë në kontakt me energjinë elektrike dhe, si pasojë e goditjes, ka humbur jetën.



Klajdi Zekthi

Por tragjedia e Belshit nuk është një rast i izoluar.

Lexo edhe:

[E rëndë në Belsh/ Ra në kontakt me energjinë elektrike, humb jetën elektrikisti 32-vjeçar i OSHEE-së \(Emri\)](#)

[Gati 32% të shqiptarëve në pasiguri ushqimore, katër herë mbi mesataren europiane](#)

Ky është rasti i pestë i raportuar gjatë vitit 2026 ku një punonjës i sektorit të rrjetit elektrik humb jetën gjatë punës. Dhe kur vdekjet përsëriten me të njëjtën skemë, në shtyllë, në linjë, në terren, atëherë nuk flitet më thjesht për aksident por për një sistem sigurie që nuk po mbron njerëzit e vet.

Katër ditë më parë një punonjës i bashkisë humbi jetën teksa po vendoste shtyllat e ndriçimit përgjatë rrugës, në Tropojë, pasi dyshohet se ra në kontakt me korrentin. Tre punonjës të tjerë mbetën të plagosur.

Për ngjarjen policia ka ndaluar dy zyrtarë të institucionit, të dyshuar për shkelje të rregullave të mbrojtjes në punë.

Bëhet fjalë për Ndrim Gjocaj, 36 vjeç, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Turizmit, Shërbimeve Publike dhe Transportit, si dhe Gëzim Hasanpapaj, 60 vjeç, drejtues teknik i punimeve. Të dy, banues në Bajram Curri, dyshohen për veprën penale “Shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë”.

Në shkurt, në fshatin Rrilë të Lezhës, humbi jetën 27-vjeçari **Mark Prenga**, elektrikist i OSHEE-së, pasi ra në kontakt me rrymën gjatë riparimit të një defekti në shtyllë. Pas ngjarjes u proceduan katër punonjës të tjerë të OSHEE-së për shkelje të rregullave të sigurisë teknike.

Më 22 korrik, në Himarë, humbi jetën **Bashkim Boçi**, 55 vjeç, punonjës i OSHEE-së prej vitesh. Ai po punonte për rikthimin e energjisë pas stuhisë, kur dyshohet se iu shkëput rripi i sigurisë dhe ra nga një shtyllë rreth 9 metra e lartë.

Ndërsa më 11 shtator, në Marglliç të Patosit, humbi jetën **E.D.**, 46 vjeç, nga Elbasani, pranë një shtylle elektrike të rrëzuar.

Megjithatë, katër ngjarjet kanë një element të përbashkët: punonjës që dalin në terren për të ndërhyrë në rrjet dhe që nuk kthehen më në shtëpi.

Kur të njëjtat skena përsëriten brenda pak muajsh, pyetja nuk mund të jetë vetëm se si ndodhi aksidenti. Pyetja është nëse janë zbatuar në çdo rast të gjitha masat që duhet të parandalonin një fatalitet.

A ishte ndërprerë energjia në linjën ku po punohej? A kishte urdhër pune të dokumentuar dhe procedurë të qartë sigurie? A ishin kontrolluar pajisjet mbrojtëse përpara ndërhyrjes? A ishte vlerësuar rreziku i punës në terren, veçanërisht pas stuhive dhe dëmtimeve të rrjetit?

A kishin punonjësit kushtet dhe kohën e nevojshme për të zbatuar të gjitha protokollat? Dhe mbi të gjitha: çfarë ndryshon pas çdo tragjedie?

Në njoztimet e para, ngjarjet shpesh përmbidhen me traza si “ra ne kontakt me rrymen”, “ra nga shtylla” apo “po riparonte nje defekt”. Por pas ketyre njatime qëndron një zinxhir përgjegjësish që duhet hetuar deri në fund.

Nëse ka pasur shkelje të protokolleve, përgjegjësia duhet të përcaktohet. Nëse protokollet janë zbatuar, atëherë duhet shpjeguar se çfarë tjetër dështoi për të mbrojtur punonjës.

Etiketa: [elektricitOSHESiguriaterren](#)

Lajme të lidhura




[E rëndë në Belsh/ Ra në kontakt me energjinë elektrike, humb jetën elektricisti 32-vjeçar i OSHEE-së \(Emri\)](#)

12:16 : 12/09/2026




[Gati 32% të shqiptarëve në pasiguri ushqimore, katër herë mbi mesataren europiane](#)

08:35 : 24/08/2026



["Turizmi nuk ndërtohet me statistika", deputeti i PD: Në Lezhë mungojnë uji, dritat dhe siguria](#)

21:37 : 20/08/2026





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.